

VENDIM
Nr.287, datë 23.4.2004

PËR LEJIMIN E INSTITUCIONEVE BUXHETORE TË PËRDORIN PROCEDURËN
“PROKURIM I DREJTPËRDREJTË” PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË MJETEVE
TË TYRE MOTORIKE PËR PËRGJEGJËSITË NDAJ PALËVE TË TRETA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e institucioneve buxhetore që, për fondet limit të miratuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2004, të përdorin procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë” me INSIG sh.a. për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve të tyre motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta.

2. Primi që INSIG, sh.a. do të arkëtojë nga institucionet buxhetore, të jetë vlera e primit të pastër, shtuar vlerën e shpenzimeve minimale administrative, të përcaktuara me urdhër të Ministrit të Financave.

3. Ngarkohen drejtuesit e institucioneve buxhetore për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano